



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 274, datë 06.12.2019

**PËR
RIFILLIMIN E VEPRIMTARISË DHE SHËRBIMEVE GJYQËSORE NË GJYKATËN
ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DURRËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet, 147/1, 147/a, pika 1 germa “d” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61 të Ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, në Vendimin nr. 267, datë 02.12.2019 të Këshillit, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në gjykatat e qarqeve Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, si dhe në akt-konstatimin e Institutit të Ndërtimit për godinën ku ushtron veprimtarinë e saj Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës,

VENDOSI:

1. Rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në datën 06.12.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR